



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
SKUPËTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Raporti mujor: Për muajin Qershor-2017

POZICIONI : Basri Hashani, drejtor i DRSK-së

1. ZGJIDHJA E LËNDËVE NË PROCEDURË ADMINISTRATIVE TË PRANUARA NGA PALËT

Tabela-1,1 – Pasqyra totale e lëndëve të pranuar nga palët

Gjithsejt	Të Aprovuara	Të Refuzuara	Në Procedurë	Të Pazgjdhura
12	9	-	3	-

Tabela- 2 Kërkesa të parashtruara për Arkivin Komunal – Lipjan

Kërkesat e parashtruara	Të realizuara	Numri i dokumenteve të lëshuara(kopje nga Arkivi)	Në proces	Vrejtje
11	11	117	-	Janë inkasuar 58.50€

Tabela-3 Raport për Bibliotekën e Qytetit dhe Bibliotekat në teren

Libra huazim në	Libra të kthyera	Lexues te rinj	Përpunimi i librit	Lexus në sallën e leximit
986	932	123	176	660

- Kemi punuar raportin për muajin Qershorë.
- Kemi marrë pjesë në punimet Kuvendit .
- Në kuadër të Kuvendit ,kuvendi ka marr vendim që Subvencionet e rekomanduara nga komisioni dhe të propozuara nga Kryetari Imri Ahmeti të aproohen dhe tash pritet edhe afati i përcaktuar me ligj dhe të nënshkruhen kontratat mes Klubeve Sportive dhe Kryetarit të Komunës.
- Muajin qershor e fillojmë me organizimin me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve ,fillimisht një grup i fëmijëve nga fshati Konjuh ka vizituar Administratën komunale ku me këtë rast janë pritur nga Kryetari I Komunës, këtyre fëmijëve në shenjë falenderimi ju është shtruar edhe një koktej rasti .
- Me një program argëtues në Qendren Sportive është organizuar një Program ku nxënësit e shkollave fillore të Qytetit dhe Shkolla fillore e „Ernest Koliqi “ nga Babushi kaë dhënnjë program kulturor për fëmijët .
- Po të nejtën ditë nxënësit e Shkollës fillore „Dy Dëshmorët “ nga Dobraj kanë dhënë një shfaqje teatrale për fëmijë.
- Gjatë muajit qershor një numër i madh i aktiviteteve të parapara nga DKRS janë pezulluar për shkak të Fushatës zgjedhore ,për zgjedhjet nacionale.
- Qendren Kulturore dhe Qendren Arsimor Sportive, hapsirat e tyre i kanë shrytëzuar Partitë Politike për fushatë.
- Gjithashtu gjatë këtij muaji Qendren Kulturore e kanë shrytëzuar edhe Bashkësia Islame e Kosovës dega në Lipjan ,ku për xhematin e tyre kanë organizuar Ligjerata .
- Me rastin e Ditës së Çlirimit të Lipjanit , DKRS ka organizuar në bashkëpunim me Kryesuesen e Kuvendit Mbledhje Solemne , më pas gjatë ditës është organizuar edhe një Koncert Festiv me grupet Lipjane dhe Grupin PRO BAND & GANJA .
- Me rastine 14 qershorit Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Lipjanit, fillimisht janë vendosur Buqeta lulesh në Lapidarët dhe Komplekset Memoriale të Dëshmorëve DKRS ka organizuar Akademi Përkujtimore për Dëshmorët dhe më pas në rrespekt të Familjeve të Dëshmorëve është organizuar edhe një lftar për gjithë familjarët .
- Në bashkëpunim me OJQ D4D kemi organizuar një tryezë me të rinj me temën ,, gjendja e Sistemi Arsimor në Shkolla “
- Në Qendren Kulturore është shfaqur Premiera e shfaqjes teatrale ,, Dukuritë negative tek të rinjtë “ ,Të mbajtur nga OJQ ,,Kursi I aktrimit – Lipjan”.
- Me kërkesë të Kryetarit Imri Ahmeti kemi përpiluar një kërkesë për Ministrin e Kulturës me disa prioritete në investime infrastrukturore në lëmin e sportit ,kjo kërkesë është bërë që të futen në projeksionet buxhetore të MKRS-së për vitrin 2018.

- Delegacioni i kryesuar nga Nënkyetari Sefer Tasholli ka marrë pjesë në funeralin mortor të veteranes së arsimit Vezire Gjraku – Selimi (ish bashkshortja e Atdhetasrit Adem Gllavica)
- Muajin e përmbylim me një aktivitet sportive të organizuar nga AKK ku ne si Komunë kemi marrur pjesë dhe jmi në mesin e 4 komunave më të mira të Kosovës në futboll.